



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 0A-126
Datë: 27.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **Qendra e Formimit Profesional "Kryolan"** në Prishtinë, për periudhën **01.02.2017** deri **01.02.2020** për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:
 - 1.1. **Parukeri; Niveli III sipas KKK**
 - 1.2. **Grimer; Niveli III sipas KKK,**
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim pwr profilin Parukeri:
 - 2.1 Ofrimi i dëshmisë për vlerësimin e performancës së stafit nga ana pedagogjike për mësimdhënie në qendër.
 - 2.2 Të ndërtohet modeli testi modular dhe përfundimtar me pyetje: a).Teori me zhvillim; Pyetje alternative-Pyetje gojore; b). Punim mbi modele reale.
 - 2.3 Data e fillimit procesit mësimor për gjithë kandidatët e regjistruar për çdo grup të ri të formuar të jete unike.
 - 2.4 Të vendoset në ambientet e qendrës kutia e të vërtetës dhe ajo e ndihmës së shpejtë.
 - 2.5 Të vendosen në ambientet e qendrës tabelat orientuese të identifikimit të hapësirave të saj

- 2.6 Të vendoset kodi i mirësjelljes brenda hapësirës ku zhvillohet trajnimi.
 - 2.7 Për të patur një zbatim sa më të mirë të plan-programit të paraqitur nga qendra, paneli konstatoi që asistentet duhet të trajnohen me pjesëmarrje të vazhdueshme në seminare në fushën e parukerisë.
 - 2.8 Të trajnohet stafi dhe të certifikohet në drejtim të mësimdhënies dhe të metodologjisë.
 - 2.9 Stafi të trajnohet për kandidatët me aftësi të kufizuar, për të patur sa më të lehtë implementimin e programit për parukerinë të kësaj qendre edhe për këtë kategori kandidatësh.
3. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Grimer:
- 3.1 Data e fillimit procesit mësimorë për të gjithë kandidatëve të regjistruar për çdo grup të ri të formuar të jete unike.
 - 3.2 Të vendoset në ambientet e qendrës kodi i mirësjelljes.
 - 3.3 Të vendoset në ambientet e qendrës kutia e të vërtetës
 - 3.4 Të vendoset në ambientet e qendrës kutia e ndihmës së parë
 - 3.5 Të rregullohen kushtet higjieno-sanitare të tualetit të qendrës
 - 3.6 Vendosja në mënyrë të dukshme e indikacioneve të daljeve të emergjencës dhe e kutisë së ankimit në një vend që nuk ruhet nga kamerat.
 - 3.7 Të trajnohet stafi dhe të certifikohet në drejtim të mësimdhënies dhe të metodologjisë.
 - 3.8 Stafi të trajnohet për kandidatët me aftësi të kufizuara, për të patur sa më të lehtë implementimin e programit të grimit, pasi në këtë qendër janë krijuar të gjitha mundësitë që të trajnohen këta individë.
4. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim për profilin Parukeri duhet të përmbushen deri më datën **01.05.2017**, ndërsa për profilin Grimer deri më datën **31.05.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

6. Vendimi u dërgohet:

- Kryolan;

- AKK.

 Bedri Xhafa
Anëtar i KD së AKK-së